



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM

VENDIM

Nr.30, datë 20/09/2023

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS “PËR RINOVIMIN E KUSHTEVE TË
LEJES/AUTORIZIMIT”, SUBJEKTIT “E.H.W” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime sanitare, Leje me Nr.serie:0013, miratuar nga KBU Ishëm-Erzen me Vendim Nr.12, datë 12.07.2018, subjektit “E.H.W” sh.p.k, me vendndodhje, autostrada Tiranë-Durrës km 4.8, Nj.A Kashar, Bashkia Tiranë, sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e përcaktuar e pus-shpimit (KRGJSH)

- X= 479155
 - Y= 4579635
 - Z=80 m.m.n.d
-
- Prurja mesatare : $Q_{mes}= 4 \text{ l/s}$
 - Sasia e ujit në përdorim : $Q=0,6 \text{ l/s}$
 - Qëllimi i përdorimit : Për qëllime sanitare (Në fabrikën e përpunimit të produkteve të mishit)
 - Shkarkimi i ujërave të përdorur : Depurator, trajtim paraprak dekantimi dhe shkarkim në lumin e Lanës.
-
3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU ISHËM

EMILJAN JANI

